

**Programi për integrimin dhe ri - integrimin
në shoqëri të të miturve në konflikt ose në
kontakt me ligjin përmes normave dhe
vlerave shoqërore në respektim të ligjit**

.....

**Social Integration and Re-integration
Programme of children in contact or
conflict with the law through norms,
values and a law - abiding lifestyle**



Rrjeti për Zhvillim Komunitar
"Sot për të Ardhmen"
"Today for the Future"
Community Development Network



Programi për integrimin dhe ri-integrimin në shoqëri të të miturve në konflikt ose në kontakt me ligjin përmes normave dhe vlerave shoqërore në respektim të ligjit

Social Integration and Re-integration Programme of children in contact or conflict with the law through norms, values and a law - abiding lifestyle



Rrjeti për Zhvillim Komunitar
"Sot për të Ardhmen"
"Today for the Future"
Community Development Network

Mbështetur nga:
Supported by:



United Nations
ALBANIA



Ky botim u mundësua në kuadrin e programit “Integrimi dhe Ri-Integrimi i të miturve në shoqëri nëpërmjet normave, vlerave dhe të jetuarit sipas ligjit”, zbatuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” në partneritet me UNICEF Shqipëri, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e rrjetit “Sot për të Ardhmen” dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF Shqipëri apo të Qeverisë Suedeze.

Botimi paraqet metodologjinë e ndërhyrjes, rezultatet e arritura gjatë zbatimit të programit, si dhe mesazhe të të miturve dhe prindërve që morën pjesë në këtë program.

Mesazhet e të miturve dhe prindërve janë zhveshur nga çdo lloj e dhëne që cenon konfidencialitetin e të dhënave personale dhe të drejtat e fëmijëve.

Fotot e publikuara në këtë botim janë marrë gjatë veprimtarisë së projektit me miratimin e prindërve dhe të miturve. Në kuadër të ruajtjes së të dhënave personale, konfidencialitetit dhe në mbrojtje të të drejtave të të miturve, disa pjesë të fotove janë të sfumuara, si dhe fotot e vendosura pranë mesazheve, nuk janë të lidhura me përmbajtjen, situatat apo me të miturit dhe prindërit e rastit konkret që përmendet aty.

Publikuar nga: Rrjeti “Sot për të Ardhmen”, Shqipëri

E Drejta e Autorit: © 2016 UNICEF Shqipëri,

Rrjeti “Sot për të Ardhmen”, Shqipëri

Kopertina:

Foto e përparme e kopertinës: *foto e marrë gjatë veprimtarisë së projektit, ku një i ri vullnetar shpreh angazhimin e tij për të mbështetur të miturit në konflikt/kontakt me ligjin.* © “Sot për të Ardhmen”, me miratimin e vullnetarit të ri.

Foto e pasme kopertinës: *foto e marrë gjatë veprimtarisë së projektit, ku atë e bir ndërtojnë marrëdhëniet midis tyre, nëpërmjet punës në interes të komunitetit.* © “Sot për të Ardhmen”, me miratimin e babait dhe të të miturit.

ISBN: 978-9928-4302-2-9

This publication was developed in the framework of the “Social integration and reintegration of children through norms, values and law-abiding lifestyle” Programme, implemented by the Community Development Center “Today for the Future”, in partnership with UNICEF Albania, with the financial support of the Swedish Government.

The views expressed in this publication are the responsibility of “Today for the Future” Network and do not necessarily reflect those of UNICEF Albania or those of the Swedish Government.

The publication presents the intervention methodology, achieved results during implementation and messages of children and their parents involved in the programme.

Messages of children and parents are devoid of personal identifiable data to preserve confidentiality and child rights.

Enclosed photos are taken during the programme activities with the consent of parents and children. To protect personal data, confidentiality and child rights, parts of photos are blurred. Photos placed next to children’s stories are not linked to the content or the situation of the individual child or parent concerned.

Published by: “Today for the Future” Network, Albania

Copyright: © 2016 UNICEF Albania,

“Today for the Future” Network, Albania

Cover Photos:

Front cover photo: *photo taken during programme activities, where the young volunteer is expressing his commitment to support reintegration of children in conflict with law.* © “Today for the Future” with the consent of the young volunteer

Back cover photo: *photo taken during programme activities, where father and child are rebuilding their relationship through their joint community work.* © “Today for the Future” with consent of the father and child

ISBN: 978-9928-4302-2-9

Përmbajtja / Table of Contents

MIRËNJOHJE	
ACKNOWLEDGMENTS	2
DY FJALË	
FOREWORD	3
PREZANTIMI I PROGRAMIT	
PROGRAMME OVERVIEW	4
METODOLOGJIA E NDERHYRJES	
INTERVENTION METHODOLOGY	7
a. Të dhëna mbi pjesëmarrjen e të miturve dhe prindërve. a. Data on children and parents participation.....	14
b. Tipologjia e rasteve, kategorizimi i mjedisit dhe shkaqeve influencuese b. Typology of cases, classification of environment and push factors.....	15
c. Perceptimi i të miturve mbi aktorët / shkaqet që nxitin sjelljen deviante c. Children's perceptions about the factors / causes that lead to deviant behaviour.....	17
d. Perceptimi i prindërve mbi faktorët / shkaqet që nxisin sjelljen deviante d. Parents' perception of the factors / causes that lead to deviant behaviour.....	18
e. Njohja dhe qëndrimi ndaj aspektit dhe roleve gjinore nga prindërit dhe të miturit e. Awareness and attitudes with regard to gender equality and/or gender stereotyped roles among parents and children.....	18
Përfundime: Conclusions:.....	20
Situata / stereotipe: Situations / stereotypes:.....	20
REZULTATET	
RESULTS	23
DISA REFLEKTIME	
SOME REFLECTIONS	26
MESAZHE NGA TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN DHE PRINDËRIT E TYRE	
MESSAGES FROM CHILDREN IN CONFLICT WITH THE LAW AND THEIR PARENTS	29

Mirënjohje / Acknowledgments

Rrjeti “Sot për të Ardhmen” shpreh mirënjohjen ndaj UNICEF Shqipëri për mbështetjen në punën me të miturit në konflikt dhe në kontakt me ligjin, me prindërit e tyre dhe për ndihmesën dhe partneritetin e vazhdueshëm të dhënë gjatë gjithë kohës, si dhe Qeverinë Suedeze për kontributin financiar të mundësuar.

Çmujmë mbështetjen dhe bashkëveprimin e institucioneve në Tiranë, Durrës dhe Pukë si gjykatat, zyrat e Shërbimit të Provës, Prokuroria, Policia, Drejtoritë Arsimore Rajonale, shkollat 9-vjeçare e të mesme, si dhe shkollat e arsimit profesional.

Falenderojmë prindërit dhe mësuesit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në misionin e lartë të edukimit dhe të mirërritjes së fëmijëve dhe të rinjve në konflikt/kontakt me ligjin, si dhe në sigurimin e integritet të tyre social në përputhje me vlerat dhe normat në respektim të ligjit.

Falenderimet më të veçanta janë për fëmijët dhe të rinjtë që pavarësisht situatave personale, hodhën hapat e parë në ndërtimin dhe rindërtimin e së ardhmes së tyre, me mbështetjen e një grupi të tërë profesionistësh dhe vullnetarësh nga Rrjeti “Sot për të Ardhmen”: punonjës socialë, psikologë, juristë, mentorë, si dhe me përfshirjen e prindërve të tyre, ekspertëve të institucioneve të drejtësisë dhe komunitetit. Tashmë procesi i mëtejshëm ka një bazë të ngritur sigurie dhe vetëbesimi në integritetin dhe ri-integritetin e tyre në një shoqëri të shëndetshme, bazuar në vlera dhe norma që mbështetnin zbatimin dhe sundimin e ligjit.

* * *

“Today for the Future” Network would like to acknowledge UNICEF, Albania for its support in working with children in conflict or in contact with the law, their parents and its continuous partnership, as well as the generous financial contribution of the Swedish Government.

We appreciate the support and cooperation of public authorities in Tirana, Durrës and Puka, namely: courts, probation offices, the police, Regional Education Departments, primary and secondary schools, and vocational education schools.

We would like to express our gratitude to the parents and teachers for their participation and contribution to the supreme mission of education and upbringing of children and adolescents in contact or conflict with the law, and for ensuring their social integration in compliance with the prevailing law-abiding values and norms.

Most special thanks go to the participant children and adolescents who despite their personal situations, took their first steps towards shaping and re-building their future, with the support of a whole team of professionals and volunteers of the “Today for the Future” network: social workers, psychologists, legal advisors, mentors, and with the involvement of parents as well as the justice sector and community professionals. Future interventions will already have an established basis of security and self-confidence in their integration/re-integration into a healthy society, guided by law-abiding norms and values.

* * *

Dy fjalë për programin / Foreword

Kur e nisëm këtë program, e dinim që nuk do të ishte e lehtë të bënim bashkë fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin, me prindërit, me institucionet e drejtësisë, me shkollat e komunitetin.

Kur pak nga pak nisin të "lulëzojnë" rezultatet e para, çdo formë lodhjeje dhe tensioni transformohet në energji për të punuar më tej. Është kënaqësi kur sheh një të mitur, fillimisht të inatosur me veten e shoqërinë, që nis të buzëqeshë dhe të bëhet miqësor; një fëmijë dikur të ndrydhur që tashmë shprehet lirshëm me moshatarët e tij; është kënaqësi kur sheh se si prindi dhe fëmija që më parë nuk komunikonin me njëri-tjetrin, tanimë e bëjnë rrugën bashkë si shokë; ndjehesh plot shpresë kur i sheh këta fëmijë dhe të rinj që janë gjithë ide, të rigjejnë kuptimin e jetës, të ravijëzojnë rrugën e së ardhmes së tyre dhe ta bëjnë më kuptimplotë jetesën në komunitet me nisma gjithëpërfshirëse; ndjehesh e motivuar edhe kur të gjitha institucionet dakortësohen për të bërë më të mirën për të miturit në vështirësi, në kontakt apo në konflikt me ligjin, për t'i integruar në shoqëri e për t'u dhënë shanse të barabarta me bashkëmoshatarët.

Të gjithë ne punojmë për t'u siguruar një të ardhme më të mirë fëmijëve, për t'u lënë një trashëgimi të vlefshme në vlera e qytetari. E në këtë mision të lartë, një angazhim edhe më i madh nevojitet në trajtimin e atyre fëmijëve dhe të rinjve që, për një arsye apo tjetrën, gjenden në udhëkryqin e rritjes së tyre, midis dilemave të vlerave dhe antivlerave, midis paqes dhe konfliktit.

Misioni ynë është t'u japim dorën për të rrugëtar shëndetshëm dhe detyra jonë t'u japim çdo ndihmë për të kapërcyer vështirësitë ku mund të ngërthehen dhe për t'u ri-integruar. Në një shoqëri që evoluon me shpejtësi, ku risitë por edhe rreziqet shtohen dhe zhvillohen, shpejtësia dhe saktësia e ndërhyrjeve parandaluese dhe restauruese duhet të prevalojnë, që të mundësojmë perspektivën pozitive në rritjen e çdo të mituri.

Fabiola Laço – Egro

Drejtoreshë Ekzekutive / *Executive Director*

QZHK Sot për të Ardhmen / *"Today for the Future"*

When we started this programme, we knew it would not be easy to bring together children in contact/conflict with the law, with their parents, justice and law - enforcement authorities, schools and the community.

When slowly but steadily, we began to "reap" the first results, any degree of stress or tiredness transformed into more energy for further work. It is such a reward to see a child, once angry with him / herself and with the society, begin to smile and become friendly again; a timid and frustrated child begin to freely speak their mind in the presence of their peers; it is a joy to observe once estranged parents and children, communicate with each-other and walk side by side as friends; you feel hopeful when you see these children and adolescents full of ideas, beginning to find a meaning to their lives, shaping their futures and making life in their community richer through contributing to inclusive initiatives; you feel motivated when all public authorities commit to do their best for children in distress, children in conflict or contact with the law, to ensure their integration in society and to provide them equal opportunities with their peers.

All of us work towards ensuring a better future for children, we strive to leave them a valuable legacy of civic values. In the spirit of this important mission, it is crucial to ensure a greater commitment to addressing the needs of those children and adolescents who for one reason or another are at the crossroads of their life, torn between dilemmas of values and anti-values, between conflict and peace.

Our mission is to lend a hand to these children and adolescents, walk with them towards a healthier way ahead, give them every bit of assistance to overcome any difficulty where they might be entangled and ensure their re-integration. In a rapidly developing society, with so many novelties, as well as new risks, the speed and accuracy of preventive and restorative interventions should prevail, in order to ensure a positive approach in the growth of every child.



Prezantim i Programit Programme Overview

Prezantim i Programit

“Integrimi dhe Ri-integrimi i të miturve në shoqëri nëpërmjet normave, vlerave dhe të jetuarit sipas ligjit” është fokusi i ndërhyrjes së realizuar nga **Rrjeti “Sot për të Ardhmen”** përgjatë një periudhe 13-mujore 2015-2016, në Tiranë, Durrës dhe Pukë, në partneritet me **UNICEF Shqipëri**.

Kjo ndërhyrje synon të kontribuojë në edukimin e të miturve dhe sidomos të atyre në konflikt me ligjin, për të vepruar dhe jetuar në përputhje me vlerat, normat dhe ligjet në fuqi, me qëllim që brezi i ri të jetë pjesë aktive dhe model qytetar i një shoqërie shqiptare të civilizuar dhe të përgatitur për të qenë pjesë e Bashkimit Europian.

Kjo sipërmarrje vjen si nevojë për të adresuar problematikën në rritje të të miturve, si në konflikt me ligjin, ashtu edhe si viktima apo dëshmitarë të veprave penale në familje dhe shoqëri. Gjithashtu vjen si domosdoshmëri për njohjen e kuadrit ligjor nga të miturit vetë, prindërit apo grupi social ku ata bëjnë pjesë, krijimin e besimit ndaj organeve të drejtësisë dhe atyre të zbatimit të ligjit si dhe promovimin e një kulture shoqërore që inkurajon të miturit të bëhen qytetarë që i binden ligjit dhe që përdorin rrugët ligjore për të zgjidhur problemet apo konfliktet me të cilat përballen.

Për të kontribuar në këtë qëllim madhor, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNICEF punojnë me një sërë organizatash të shoqërisë civile, puna e të cilave komplementon panoramën e gjerë të ndërhyrjeve.

Konkretisht, “Sot për të Ardhmen” si rrjet lider për mobilizimin e grupeve komunitare, kontribuon në këtë

Programme Overview

Integration and Re-integration of children in society through norms, values and living on the side of the law is the focus of the programme carried out by **“Today for the Future” Network** throughout a period of 13 months (2015-2016), in Tirana, Durrës and Puka, in partnership with **UNICEF, Albania**.

This intervention aimed at contributing to the education of children, and in particular children in conflict with the law, to act and live, in compliance with the values, norms and the law, to make sure that the new generation plays an active role and models citizenry of a civilized Albanian society, prepared for becoming eventual part of the European Union.

This process is a response to the need of addressing increasing issues/challenges in relation to children in conflict with the law, as well as children victims or witnesses of criminal offences occurring in the family or society. In addition, this initiative responds to the need of children, of their parents and of their social group to have knowledge and information about the legal framework; the need to build trust towards the law-enforcement and the justice system; the need to promote a community and social culture that encourages children and adolescents to become law-abiding citizens and to make use of the legal remedies in order to resolve the problems or conflicts they face.

To contribute to this greater purpose, the Ministry of Justice of Albania, in cooperation with UNICEF are working together with a number of civil society organizations

qëllim nëpërmjet fushës së ekspertizës së tij, duke punuar me familjen si bërthamë ku nisin vlerat dhe normat, si pikënisje shoqërore dhe si model shoqëruar për fëmijët gjatë rrugëtimit të tyre personal dhe shoqëror. Shtyllat kryesore të kësaj ndërhyrjeje ishin:

- Ndërtimi i nje programi prindërimi për prindërit e të miturve në konflikt me ligjin dhe të atyre që kishin ndërvepruar me sistemin e drejtësisë apo me policinë, për shkak të viktimizimit, kryesisht nga dhuna në familje;
- Ofrimi i disa shërbimeve shumëdisiplinore në mbështetje të drejtësisë për të mitur;
- Mbështetja e Shërbimit të Provës dhe burgjeve për të përkrahur të miturit në konflikt me ligjin për t'u ri-integruar në shoqëri dhe për t'i orientuar ata drejt një jete në respektim të ligjit;
- Krijimi i normave dhe vlerave shoqërore që i nxitin fëmijët t'i binden ligjit.

(CSOs), whose field of expertise complements the broad picture of other interventions.

Specifically, “Today for the Future” as a leading network in the area of community groups mobilization, is contributing to this end, based on its area of expertise, by working with the family as the nucleus where all values and norms start taking shape, as a social departure point, and a model that will accompany the child in his/her personal and social journey. The main pillars of this programme were:

- Building a parenting programme for parents of children in conflict with the law or children who had interacted with the law-enforcement or the justice system due to being a victim of criminal offences, primarily of domestic violence;
- Provision of multi-disciplinary services in support of child-friendly justice;
- Support to the Probation Service and detention facilities to mentor juveniles towards reintegration in society and towards a law-abiding lifestyle;
- Building society norms and values that conduce children to abide by laws.





Metodologjia e Ndërhyrjes

Intervention methodology

Metodologjia e Ndërhyrjes

Duke qenë se “Sot për të Ardhmen” punon në nivelin komunitar, është pranë problemeve të anëtarëve të komunitetit dhe familjeve dhe njëkohësisht njihet nga institucionet publike si urë ndërveprimi mes këtyre dhe komunitetit, shumë nga fëmijët dhe prindërit e tyre u identifikuan ose përmes referimit nga këto institucione publike, ose përmes kërkesave nga vetë fëmijet a familjet e tyre. Më tej, duke u hapur fjala, edhe të tjera familje iu drejtuan Rrjetit Komunitar “Sot për të Ardhmen” për t’u bërë pjesë e këtij programi.

Pas identifikimit të grupit dhe sigurimit të pjesëmarrjes së fëmijëve dhe prindërve, profesionistët e Qendrës Komunitare u përqendruan në të kuptuarit e problemeve të fëmijëve dhe të marrëdhënies së tyre me prindërit. Kështu, përmes teknikave të komunikimit, mentorët, trajnerët dhe psikologët e këtij programi, krijuan kushtet për zbulimin e individualitetit të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin, me synimin e ringjalljes së kompetencës morale, qytetare si dhe me synimin e rindertimit të marrëdhënies së tyre me prindërit, e cila në mënyrë të shumtën e rasteve u vëzhgua se që problematike. Kjo, me qëllim që përgjatë këtij procesi, prindërit të arrinin të luanin rolin e tyre mbështetës në procesin e ri-integrimit/rehabilitimit.

Përzgjedhja e kësaj ecurie psikologjike u mbështet mbi synimin natyral të çdo të mituri (*si atyre me sjellje konform standardeve shoqërore dhe ligjore, por edhe atyre në konflikt me ligjin*) për vetëveprim, vetëpërmirësim, për të krijuar një gjendje të ekuilibruar brenda vetes dhe

Intervention methodology

Given that “Today for the Future” works at the community level, operating closer to the problems of the families and the community members, and is also recognised by the public authorities as an organisation that bridges their interactions with the community, many of the parents and children who participated in the programme were either referred to “Today for the Future” by these authorities, or voluntarily requested to become part of the programme. As the first families began to attend the programme, other children and parents requested “Today for the Future” to be part of this programme that they heard of by word of mouth.

Once the groups of children and parents were identified, the professionals of the Community Centre focused on understanding the problems of children and of the relationship with their parents. Through the use of communication techniques, the mentors, the trainers and psychologists of the programme, set up the conditions for the participant children to reveal their individuality and the space for the revival of their moral and civic competence as well as the rebuilding of the relationship with their parent – very problematic in most of the cases observed. This was essential to make sure that parents took a supportive role in their children’s rehabilitation/reintegration process.

The selection of this progressive psychological process was based on the assumption of the natural goal of every child (*not just those whose behaviour is in line with the social and legal standards, but also of those those in conflict with the law*) for self-action and self-improvement,

me botën që e rrethon. E njëjta përjasje vlejti dhe për prindërit, pavarësisht nivelit të tyre arsimor, social dhe ekonomik.

Profesionistët e programit u munduan që gjatë seancave të komunikonin jo nga niveli i pozicionit apo detyrës së tyre, por u ulën në nivelin e pjesëmarrësve, me qëllim që ata të ndiheshin të lirshëm për të shprehur emocionet e tyre. **Aspekti emocional**, për shkak të peshës dhe kohëzgjatjes së tij, është shumë i rëndësishëm për modulimet e qëndrimeve etike si të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin ashtu dhe të këshilluesve të tyre (prindër, mësues, institucione riedukimi etj). Kjo dhe për faktin se emocionet janë më të lexueshme, të paktën për të miturit, por në disa raste edhe për prindërit, të cilët nuk e kanë përvojën e përballimit të tyre, nuk i njohin teknikat e manipulimit, maskimit, pakësimit, nxitjes apo neutralizimit të emocioneve.

Jo rrallë, aspekti emocional krijoi probleme, sidomos kur vetë të miturit ose prindërit nuk arrinin të pranonin të vërtetat dhe faktet reale, si pasojë e vetëbesimit në ndjenjat, botëkuptimet dhe qëndrimet e veta.

Për këtë, ndoqëm rrugën e bindjes së të miturit, që ai/ajo të pranonte edhe mendimin ndryshe të paraqitur nga një tjetër (prind, mësues, psikolog, trajner, bashkëmoshatar, etj.), të cilin ai/ajo fillimisht e kundërshtonte me mosbesim vetëm për faktin e thjeshtë se ia paraqiste një tjetër. Më pas, gradualisht përfshinin në proces prindërit dhe më pas mësuesit dhe institucionet e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë.

Thënë ndryshe, përjasja jonë ishte më shumë bashkëpunuese, në vend të rolit sundues, për të arritur një

for ensuring inner balance and with the world around them. The same approach regarding these natural, innate goals applies to parents, as well, irrespective of their education, social and economic status.

The programme professionals tried to “get down to the children’s and adolescents’ level” with a view to create the space for them to speak freely and express their feelings. The **emotional aspect**, due to its weight and duration is very important for shaping ethical attitudes/ approaches both of children in conflict/contact with the law and their counsellors (parents, teachers, rehabilitation institution, etc.). This is also due to the fact that emotions are more obvious, at least for children, but in some cases for parents, as well, for they do not have experience in overcoming them, or are not aware of the emotions manipulation, cover - up, reduction, stimulation, or neutralization techniques.

It was not uncommon for emotions to take over and lead to problems, in particular when children or parents failed to accept the reality and the facts, as a result of firm convictions in their own beliefs, attitudes and feelings.

To this end, at first we tried to convince children on the importance of accepting a different opinion expressed by someone else (whether a parent, teacher, psychologist, trainer, peer, and so on), which these participant children refused completely, merely because someone else had presented. Then we gradually began to involve parents in the process, teachers and the legal institutions.

Our approach was more cooperative and not domineering, and aimed towards: ethical win-win solutions for all

zgjdhje etike pa të humbur, duke bërë bashkë të miturit në konflikt/kontakt me ligjin, prindërit, mësuesit dhe institucionet¹, duke krijuar klimën e besimit, duke përzier qëllimin e jetës së tyre me rrjedhën e përgjithshme.

Metodologjia e ndërhyrjes është zbatuar duke kombinuar disa modele trajtimi të rasteve. Janë kombinuar modelet e sesioneve në formë rrathësh socialë: **a) programe njëpalëshe**: me grupet e veçanta të fëmijëve dhe të rinjve, nga njëra anë dhe grupet e prindërve, nga ana tjetër; **b) programe dypalëshe**: me grupe të përziera fëmijë-prindër, **c) programe trepalëshe**: me grupe të përziera fëmijë - prindër - institucione.

Metodologjia në këtë formë ka synuar rritjen e kapaciteteve të fëmijëve dhe prindërve në njohjen e kuadrit ligjor, në formimin e mendimit kritik në analizën e situatave, dhe në veprime restauruese drejt integrimit social.

Në vijim të rezultateve të ndërhyrjes, procesi vazhdoi me ndërhyrjen në dy drejtime: **a) familjen me programin e prindërimit** dhe **b) edukimin mbi barazinë gjinore** brenda familjes si faktor influencues mbi nivelin e dhunës brenda dhe jashtë familjes.

Në programet njëpalëshe, ndërhyrja është fokusuar në:

- Njohjen e të miturve (*në kontakt dhe në konflikt me ligjin*) me kuadrin ligjor dhe edukimin e tyre me normat shoqërore.
- Njohjen e prindërve (*të të miturve në kontakt dhe në konflikt me ligjin*) me kuadrin ligjor si dhe me

¹ Gjykatat, Zyrat e Shërbimit të Provës, Prokurorinë, Policinë, Drejtoritë Arsimore Rajonale, shkollat 9-vjeçare e të mesme, si dhe shkollat e arsimit profesional.

parties; bringing together children in conflict/contact with the law, their parents, teachers and public authorities¹; building a climate of trust; and mixing their life goals with the general flow.

The intervention methodology represents a combination of several models of case management. The first phase of the programme reflected a combination of several sessions in the shape of “social circles”: **a) unilateral programs**: with groups of children only, and parents only; **b) bilateral programs**: mixed groups of children and parents; **c) tripartite programs**: mixed groups, composed of children, parents and institutions.

This type of methodology aimed at familiarising children and their parents with the legal framework, at developing critical thinking in situation analysis, and at promoting restorative acts contributing to their social integration.

Building on the first phase of the programme, the process continued with a stronger focus on: **a) the individual family and parenting**; and **b) gender equality education** within the family as a factor influencing the level of violence within and outside the family.

In unilateral sessions the intervention focused on:

- Familiarising children (in contact and conflict with the law) with the legal framework, and educating them on the social norms.
- Acquainting parents (of children in contact and in conflict with the law) with the legal framework and

¹ Courts, Probation Offices, Prosecution Offices, Police, Regional Education Departments, primary and secondary schools, vocational education schools

aspektet e prindërimit, për të ndihmuar të miturit në parandalim/ri-integrim.

Në programet dypalëshe, ndërhyrja është fokusuar në:

- Përfshirjen e të miturve (*në kontakt dhe në konflikt me ligjin*) dhe të prindërve në situata zgjidhjeje konflikti (ku asnjë palë të mos ndihet e humbur) dhe për të shprehur perceptimin e tyre mbi konfliktin (*faktorë, të dëmtuar/dëmtues, zgjidhje, post-konflikt*) si dhe nivelin e përgjegjësive që merrnin përsipër.
- Nxitjen e të miturve dhe të prindërve për të ushtruar dijen e marrë në situata konkrete (*procesi i ndryshimit të sjelljes*), si dhe për ta ndarë eksperiencën me njëri-tjetrin (*në format dyshe prindër-fëmijë, në grup të kategorizuar prindër/ fëmijë, në grup miks prindër-fëmijë*)

Në programet trepalëshe, ndërhyrja është fokusuar në:

- Ndërthurjen e të gjithë aktorëve bashkë, si dhe njohjen nga afër të institucioneve të ligjit.

Ndërtimi i *sjelljes me bazë familjen*, u aplikua në *disa prej rasteve të përzgjedhura, kryesisht të fëmijëve në konflikt me ligjin*. Në këtë aspekt, metodologjia përfshiu:

- Trajtimin individual të sjelljes (të mitur, prindër);
- Ndërtimin e marrëdhënies dypalëshe prindër-të mitur;
- Përfshirjen e të miturit së bashku me prindin e vet në punë në dobi të komunitetit.
- Ri-vlerësimin e roleve brenda familjes;
- Rritjen e kapaciteve dhe aftësive të prindërimit në trajtimin e fëmijëve sidomos në adoleshencë;
- Njohjen e roleve stereotipe gjinore dhe pritshmëritë brenda familjes dhe sfidimin e tyre përmes edukimit

parenting aspects, in order to assist children in the process of prevention/re-integration.

In bilateral programs, the intervention focused on:

- Inclusion/involvement of children (in contact and in conflict with the law) and their parents in conflict resolution (win-win situations); their encouragement to share thoughts and express their perception of the conflict (factors, victims/perpetrators, resolution, post-conflict); and their encouragement to take over responsibilities for own actions.
- Urging children and their parents to apply their newly acquired knowledge to real life situations (behavioural change process), and to share their new experiences with each-other (in bilateral groups: parent-children pairs, in groups of children, groups of parents, in mixed groups of parents and children)

In tripartite programs, the intervention focused on:

- Bringing all actors together, and getting them to know more closely the legal institutions and justice professionals.

Family - based intervention for behaviour building was applied in several of the identified cases, in particular in *the families of children in conflict with the law*. In this aspect, the methodology included:

- Individual behaviour treatment (children, parents);
- Building the relationship between parents and children;
- Engagement of both the child and the parent in community work;
- Revisiting the roles of family members;
- Increasing the parenting capacity and skills of parents,

me normat e barazise gjinore;

- Qëndrueshmërinë e veprimeve pozitive brenda dhe jashtë familjes dhe përcjelljen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore në rrethin social ku bëjnë pjesë.

Në këtë projekt u përfshinë rreth 190 fëmijë dhe të rinj në konflikt/kontakt me ligjin, rreth 150 prindër, si dhe këto institucione publike: gjykatat, zyrat e Shërbimit të Provës, prokuroritë e rretheve gjyqësore, policia, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Shkollat 9-vjeçare, të mesme të përgjithshme e profesionale në Tiranë, Durrës dhe Pukë.

Mbështetur dhe në dokumentet bazë juridike, si: Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Kushtetuta e Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar në fushën e drejtësisë penale, në të gjitha sesionet e trajtimit (programet njëpalëshe, dypalëshe dhe trepalëshe) patëm si objektiva për të aftësuar të miturit:

- Për të qenë të pavarur si dhe për të marrë vendimet e duhura për veten, në momentet e duhura dhe vendin e duhur;
- Për të kuptuar veten dhe situatën;
- Për të minimizuar tensionet e të integruarit në shoqëri, nga të qenit "të ndryshëm", drejt gjetjes së vetvetes, të drejtës së zgjedhjes së lirë, pjesëmarrjes së vullnetshme, si dhe pranimin e të tjerëve "të ndryshëm". *(Vetë standardizimi i sjelljeve etike në shkollë është detyrë e vështirë për shkak të nënkulturave, grupeve kulturore e besimeve individuale etike mjaft të ndryshme).*

Këto sesione kishin gjithashtu për objektiv aftësimin e prindërve për të kuptuar të miturin, situatën dhe për të

particularly in relation to adolescence;

- Understanding gender stereotypes and expectations within the family and challenging them through education with gender equality concepts;
- Ensuring sustainability of positive actions within and outside the family and building public awareness on gender equality in the respective social circles.

The project involved approximately 190 children and adolescents in conflict/contact with the law, approximately 150 parents, as well as the following authorities: courts, probation offices, prosecution offices, police, regional education departments, primary and secondary schools, general and professional, in Tirana, Durrës, and Puka.

In line with main legal instruments, such as: the UN Convention on the Rights of the Child, the Constitution of the Republic of Albania, and Albanian criminal legislation, all our programme sessions (whether unilateral, bilateral and tripartite), mainly focused on enabling participant children and adolescents:

- To be independent, and to take the right decisions for themselves, at the right moment and the right place;
- To understand oneself and the situation;
- To minimize/handle the pressure accompanying the process of reintegration, to progress from being "different" towards being oneself, towards soul searching, towards freedom of choice, conscious participation, and acceptance of others as different. *(The standardization of ethical behaviour in and of itself is a difficult endeavour due to presence of sub-cultures, different cultural groups and diverse individual ethical beliefs).*

mbështetur procesin e integritimit të tij/saj.


Këto objektiva u përpoqëm t'i arrijmë:

- Duke vendosur si qëllim parësor interesin më të lartë të të miturit;
- Duke e dëgjuar e marrë atë seriozisht;
- Duke mbajtur parasysh moshën dhe nivelin e të kuptuarit;
- Duke e informuar dhe përfshirë në të gjitha çështjet dhe vendimet që ndikojnë në jetën e tij;
- Duke shmangur izolimin e tij;
- Duke mos injoruar përmasat kriminale të pasojave të keqtrajtimit të të miturit;
- Duke përfshirë prindin në të gjithë këtë proces e duke ndjekur të gjitha hapat sa më sipër.

The sessions also aimed at building the ability of parents to understand the child/adolescent, their situation, and to support them in the process of their integration.

We tried to achieve these objectives by:

- Placing at the forefront the best interest of the child;
- Listening to them, and taking them seriously;
- Taking into account their age, and level of understanding;
- Informing and involving them in all matters and decisions that affect their lives;
- Avoiding their isolation;
- Not neglecting the criminal dimensions of violence.
- Involving parents throughout the process, while following all of the above-mentioned steps.



A. Të dhëna mbi pjesëmarrjen e të miturve dhe prindërve

Pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve paraqitet më e lartë në Tiranë, ndërsa pjesëmarrja gjinore është 56% djem dhe 44% vajza.

Shkalla e përfshirjes së të miturve në veprimtari në konflikt me ligjin është më e lartë në Tiranë dhe Durrës, që lidhet me problemet që shoqërojnë zhvillimin metropolitan të këtyre rajoneve dhe përballjen e popullsisë në tërësi dhe të të rinjve në veçanti, me teknologjinë, urbanizimin, migrimin e brendshëm, papunësinë, dhe nevojën për integrim social. Ndryshe nga Tirana dhe Durrësi, rasti i të rinjve në Pukë lidhet me probleme që shoqërojnë mungesën e zhvillimit të rajonit dhe përballjen e popullsisë në tërësi dhe të të rinjve në veçanti me izolimin gjeografik, varfërinë, mungesën e zhvillimit social dhe teknologjik, etj.

Vihet re që numri i vajzave krahasuar me djemtë është më i ulët në tërësi, megjithatë tendenca e përfshirjes së tyre në sjellje konfliktuale, problematike dhe në konflikt me ligjin është më e lartë në Tiranë dhe Durrës, për të njëjtat arsye si më lart, por duke shtuar dhe elementin e mentalitetit: ndrydhja gjinore - më e theksuar në Pukë, përkundër nevojës për pranim nga grupet sociale autoktone në dy zonat e tjera.

Rreth 80% e prindërve të të miturve morën pjesë në projekt, si mbështetës të fëmijëve, por edhe si përfitues të drejtpërdrejtë të ndërhyrjes (shih seksionin "Metodologjia e Ndërhyrjes").

Megjithatë raporti i pjesëmarrjes së prindërve krahasuar me të miturit ndryshon nga zona në zonë.

A. Data on children and parents participation

Participation of children and adolescents is higher in Tirana, while gender participation rate is 56% boys and 44% girls.

The risk of children's involvement in activities in conflict with the law is higher in Tirana and Durrës, which is an indication of the problems that accompany the metropolitan development of these regions and encounter of both the general population, and of adolescents in particular with technology, urbanization, internal migration, unemployment, and the need for social integration. Unlike Tirana and Durrës, the case of children and adolescents of Puka is linked with problems related to lack of development of the region where the population in general, and adolescents in particular, face geographical isolation, poverty, lack of social and technology development, etc.

It is evident that the number of girls compared to that of the boys is lower overall, but the trend of girls involvement in conflictual or otherwise problematic behaviour or the risk of them being in conflict with the law is higher in Tirana and Durrës, for the same reasons as above, but with the additional element of the dominating mentality: women and girls oppression in Puka, and the need for acceptance in social groups in the other two areas.

Approximately 80% of the parents participated in the project, to support their children and as direct beneficiaries of the intervention (ref. Methodology of intervention).

However, the participation rate of parents compared to that

U vu re se pjesëmarrja e prindërve u ndikua nga disa faktorë:

- 1) Pjesëmarrja e prindërve është në përpjesëtim të drejtë me tendencën e pjesëmarrjes së vajzave (*ndjeshmëri më e lartë e prindërve ndaj sjelljeve problematike të vajzave, se sa të djemve*);
- 2) Në zona të vogla, ku njohjet shoqërore janë më të larta, ndjesia e "turp-it shoqëror" të prindërve është më e lartë, gjë që sjell pjesëmarrje më të ulët të tyre në program (*rasti i Pukës*);
- 3) Në zona me ritme të larta zhvillimi, prindërit përballen me kohë më të kufizuar, bashkëjetesë më mikse të grupeve të ndryshme, konkurrencë më të lartë për punë etj. Kjo bën që ata të shfaqin tendencën e shpërndarjes nga rritja e fëmijëve, sidomos në aspektin e njohjes së tyre, nuk kalojnë kohë cilësore të mjaftueshme me ta dhe e kuptojnë ngushtë prindërimin vetëm në sigurimin e të mirave materiale dhe aksesit. (*Ky është tipikisht rasti i Tiranës, ku edhe pjesëmarrja e prindërve është më e ulët, krahasuar me atë të fëmijëve*).

of children differs from one area to the other

The participation of parents was influenced by several factors:

- 1) The rate of parents' participation has a positive correlation with the participation of girls (*higher sensitivity of parents towards the problematic behaviour of daughters, as compared to that of their sons*);
- 2) In smaller communities, where the social relations are more intense and everybody knows everybody, the feeling of the so-called "social shame" among parents is higher (*the case of Puka causing a lower parent participation rate*);
- 3) In areas with higher development rates, limited time availability, heterogeneity of community composition, higher competition for jobs, etc., (*the case of Tirana, with lower participation rates*), parents seem to display some distance from the upbringing of their children, particularly in terms of getting to know them, spending quality time with their children, etc., and they tend to limit their views of parenting to just providing material things and access.

B. Tipologjia e rasteve, kategorizimi i mjedisit dhe shkaqet e influencues

Gjatë trajnimeve, diskutimeve dhe sesioneve të këshillimit, fëmijët dhe të rinjtë, si dhe prindërit shprehën opinionin e tyre mbi faktorët, shkaqet dhe peshën e tyre në situatat e të miturve në konflikt ose kontakt me ligjin, si

B. Typology of cases, classification of environment and push factors

During the training, discussion and counselling sessions, children/adolescents and their parents expressed their views on the factors, causes, and their weight in the situations of children in conflict or contact with the law, as

dhe mendimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e aktorëve influencues në situata të tilla.

Sipas të dhënave zyrtare veprat penale në të cilat përfshihen më shumë të rinjtë janë:

- x *vjedhja*
- x *drejtimi i automjetit në gjendje të dehur ose pa dëshmi*
- x *shkatërrimi i pronës*
- x *prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*

Krahasimisht, veprat penale dhe sjelljet problematike ndaj dhe nga të miturit e përfshirë në programin tonë ishin kryesisht:

- x *Dhuna në familje / shkollë / shoqëri*
- x *Vjedhja*
- x *Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*
- x *Krimi kibernetik (përndjekja, pengimi, shkelja e konfidencialitetit, etj.)*

Në këto sesione prindërit dhe fëmijët listuan këto kategori kryesore influencuese, të aspektit socio-ekonomik: **Arsimi, gjendja ekonomike, shkalla e njohjes me ligjin** dhe përbërja familjare. Ndërkaq, si rrathët socialë kryesorë të

well as on the roles and responsibilities of the influencing actors in such circumstances.

According to court and prosecution official data, the following represent some of the criminal offences whereby children are likely to get more involved in:

- x *stealing*
- x *drunk driving, or driving without a driving license;*
- x *property destruction*
- x *production and sale of drugs*

Whereas, the criminal offences and problematic behaviours of and against children participating in our intervention were mainly:

- x *domestic violence/violence at school/society*
- x *stealing*
- x *Production and sale of drugs*
- x *Cybercrimes (stalking, violation of confidentiality, oppression, etc.)*

In the discussion sessions parents and children / adolescents listed the following socio - economic categories of influential factors: **education, the economic status, awareness of**



aspektit mjedisor influencues u listuan: **Familja, shkolla dhe grupi shoqëror.**

Përtej faktorëve të listuar nga prindërit dhe fëmijët, trajnerët dhe mentorët vëzhguan ekzistencën e faktorëve të tjerë influencues:

- x *Ekzistenca e dhunës në familje*
- x *Stereotipet mbi rolet gjinore në familje të cilat u trajtuan thellësisht gjatë fazës së dytë në programin e prindërimit.*

C. Perceptimi i të miturve mbi faktorët/shkaqet që nxitin sjelljen deviante

Sipas tyre:

Në mjedisin familjar, ata listuan një sërë faktorësh që nxitin sjelljen problematike të tyre, të renditur për nga rëndësia si më poshtë:

- a) dhuna psikologjike, fizike dhe verbale e ushtruar nga anëtarët e familjes ndaj tyre, ose ndaj një anëtari tjetër
- b) gjendja ekonomike dhe statusi social i familjes
- c) mosmarrëveshjet në tërësi

Në mjedisin e shkollës, ata listuan faktorë si bullizmi, ndjesia e të qenurit të marginalizuar, përjashtimi social, konfliktet mes moshatarëve dhe mësuesve, marrëdhëniet me mësuesit për ecurinë në shkollë etj.

Në mjedisin shoqëror, ata listuan në përgjithësi faktorë si talljet, fyerjet (bullizmi) direkte (individuale dhe në grup) si

the law (or lack thereof) and family composition. They also mentioned the following social circles of the influencing environment: **The family, the school and the social group.**

In addition to the factors indicated by parents and children, the trainers and mentors observed the presence of the following influential factors:

- x *Domestic violence*
 - x *Gender stereotyped roles in the family*
- These latter factors received a stronger focus during the second phase of the parenting programme.*

C. Children's perceptions about the factors/causes that lead to deviant behaviour

According to them:

In their **home (family) environment**, they listed a number of factors that contribute to problematic behaviours, ranked as follows:

- a) psychological or physical violence, and verbal abuse by or against members of their own household.
- b) the family social and economic status.
- c) disputes/disagreements in general.

In **the school environment**, among the factors, they listed: bullying, the feeling of being marginalized, social exclusion, conflicts among peers and relations with the teachers about school progress.

In the social environment, they listed factors such as: insults, bullying - whether direct (individual or in group) or

dhe në rrjetet sociale, (facebook, instagram etj.), si dhe kërcënimet e ndryshme si një nivel më i rënduar i situatave konfliktuale

Raporti Koleman¹: vërtetoi se ndryshimet mes nivelit të të miturve për sa i përket përfshirjes në sjellje konfliktuale sociale, shpjegohen në pjesën më të madhe prej kushteve familjare dhe pozitës shoqërore, dhe jo prej shkollës dhe edukatorëve.

D. Perceptimi i prindërve mbi faktorët / shkaqet që nxisin sjelljen deviante

Pavarësisht se si të miturit, ashtu dhe prindërit konkluduan në tre mjediset ku gjenerohen faktorët/shkaqet që nxitin sjelljet deviante, ndryshe nga fëmijët dhe të rinjtë, prindërit nuk ishin në gjendje të bënin një klasifikim sipas mjedisit, por i perceptonin të ndërlidhura.

E. Njohja dhe qëndrimi ndaj a spektit dhe roleve gjinore nga prindërit dhe të miturit

Duke parë nivelin e dhunës në familje, gjatë programit të prindërimit ndërhyrja targetoi dhe aspektet gjinore duke synuar njohjen e koncepteve gjinore dhe aplikimin e tyre në rolet brenda familjes.

Të dhënat para ndërhyrjes tregojnë se:

.....
2 James Samuel Coleman (1926 – 1995) - Barazia e Shanseve të Edukimit, 1966 , e njohur si Raporti Koleman

in the social media/networks (Facebook, Instagram etc.), and different types of threats, as a more aggravated level of conflictual situations.

The Coleman Report¹: proved that differences in the level of children's involvement in socially conflictual behaviours, mostly find their explanation in the family and social status, and not in the school they go to, or who are their teachers.

D. Parents' perception of the factors / causes that lead to deviant behaviour

Even though parents, like their children concur about the three environments that generate the push factors for deviant behaviour, unlike children/adolescents, they were not able to rank them according to the environment, but they viewed them as inter-related.

E. Awareness and attitudes with regard to gender equality and / or gender stereotyped roles among parents and children

Observing the prevalence of domestic violence in the course of the implementation of the programme, the gender equality elements began to demand a stronger

.....
2 James Samuel Coleman (1926 – 1995) – Equality of Educational Opportunities, 1966 , known as “Coleman Report”

- Rreth 75% e prindërve dhe 71% e të miturve me dhunë në familje, nuk kishin aspak ose kishin pak njohuri mbi konceptet gjinore.
 - Ndërsa në lidhje me rolet gjinore në familje 69% e prindërve dhe 59% e të miturve, nuk kishin aspak ose kishin pak njohuri mbi rolet gjinore.
 - Të pyetur për qëndrimin personal ndaj dhunës, 56% e prindërve dhe 41% e të miturve, e konsideronin ose të pranueshme ose të justifikueshme ushtrimin e dhunës.
- focus, aiming at equipping participants with information on gender equality and encouraging them to apply gender equality concepts within their family.
- Pre-intervention data indicate that:
- Approximately 75% of parents and 71% of those participant children who were exposed to domestic violence had no or very little knowledge of gender equality concepts.
 - 69% of parents and 59% of children had no or very little knowledge/awareness of gender roles and stereotypes in the family.
 - Asked to comment on their personal attitudes towards violence, 56% of parents and 41% of children believed violence was either acceptable or justified.



Përfundime:

Si të miturit, ashtu dhe prindërit përpiqen të “mbrojnë” ose “t’i mbajnë anën” mjedisit të tyre të ngushtë, **prarethi shoqëror për të miturit dhe familja për prindërit.**

Të dy palët janë kritikë ndaj mjedisit të shkollës dhe nga ana tjetër e shohin si mjedis dominant: **të miturit shohin më shumë shkaqe që gjenerohen nga mjedisi i shkollës**, kurse **prindërit mendojnë se pesha e tyre është e madhe.**

Dhuna në familje nxit të miturit në konflikt apo në kontakt me ligjin të agravojnë sjelljen deviante. Ndërhyrja për reduktimin dhe eliminimin e saj krijon shanse për ndryshim të sjelljes të të miturit dhe prindërit dhe për qëndrueshmërinë e saj.

.....

Situata/steriotipe:

Prindërit tentojnë të justifikojnë dhe zvogëlojnë sjelljet e fëmijëve të tyre. Kështu, konfliktet e çdo lloji a përmase i quajnë si “një kalamallëk moshe”, ndaj nga ana e tyre mungon stërvitja e fëmijës se si të përballet me problemin dhe si mund të gjendet një zgjidhje sa më e mirë.

Prindërit ia “delegojnë” edukimin e fëmijëve të tyre stafit pedagogjik; rrjedhimisht i konsiderojnë dhe si përgjegjësit kryesorë për sjelljet problematike të fëmijëve të tyre.

Fëmijët duket se udhëhiqen nga dëshira për të dominuar mbi konfliktin, dhe nuk mendojnë për pasojat.

Conclusions:

Both children, and their parents try to “protect”/ or have a biased perception about their immediate/close environment, namely: **the social network for children and the family for parents.**

Both parties are critical towards the school environment, while on the other hand, they perceive it as a dominant environment: children perceive more **push factors generating in the school environment**, whereas parents believe that their weight is heavier.

Domestic violence pushes children in conflict or contact with the law to aggravate their deviant behaviour. Interventions targeting its eradication, foster opportunities for behavioural change for children and parents, and ensure its stronger sustainability.

.....

Situations/stereotypes:

Parents tend to justify and minimise their children’s behaviours. In their view, conflicts of any size or type fall under “**it’s an age thing**” sort of slogan, and therefore they do not “train” their children in facing the problem, and finding the best possible solution under the circumstances.

Parents “delegate” their children’s education to the teaching staff; consequently, they consider them as the main responsible parties for the problematic behaviour of their children.

Stafi pedagogjik shpesh mohon ekzistencën e problemit.

Shpesh prindërit e **asociojnë disiplinën ndaj fëmijëve me ushtrimin e dhunës.**

Stereotipet mbi rolet gjinore në familje shpesh influencojnë negativisht në agravimin e sjelljes deviante të të miturve në konflikt me ligjin.

Children are often driven by the desire to come out as the absolute winner in a given conflict, without calculating the consequences.

The teaching staff often denies the existence of the problem.

Parents oftentimes associate discipline with violence.


Gender stereotype roles in the family, often contribute to the aggravation of the deviant behaviour of children in conflict with the law.

Ishte pikërisht grumbullimi dhe vëzhgimi i këtyre pozitave të ndryshme që shërbeu si pikënisje për ndërhyrjen. Profesionistët bënë përpjekje që të ndërjegjësonin pjesëmarrësit për këto pikëpamje dhe besime të ndryshme dhe për t'i përafuar pak më tepër qëndrimet dhe perceptimet e tyre përgjatë zhvillimit të programit. Evidentimi i perceptimeve të mësipërme e ndihmoi edhe skuadrën e profesionistëve të programit që të kuptonin se:

- Pjesa dërrmuese e rasteve në kontakt apo në konflikt me ligjin, kanë një bazë faktorësh ndikues negativë, të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm (*të afërm abuzivë, shoqëri abuzive, përjashtim social*) dhe se ato paraqesin efekt ndikues negativ të të tjerët (*të afërm të abuzuar, shoqëri të abuzuar, ose në kontrast: izolim social*) duke dhënë efektin domino. Të rralla shfaqen rastet që burojnë vetëm nga personaliteti i të miturit.

The identification and observation of these differing standpoints served as the basis to tailor the intervention. During the implementation of the programme, our professionals tried to make participants aware of this difference in viewpoints and beliefs, and sought to bring groups to meet half way, towards closer perceptions and attitudes. Evidencing these perceptions also helped the team of professionals to understand that:

- The majority of the cases in contact or conflict with the law, have at their core a number of negative factors of the internal and external environment (*abusive family members, abusive society, social exclusion*) and have a negative impact / influence on others (*relatives that have been victims of abuse, society that has been abused or in contrast: social isolation*) which lead to a domino effect. Very few cases are solely related to the



- Kuptueshmëria e ndodhjes në një situatë në kontakt/konflikt me ligjin dhe e faktorëve ndikues nuk është e njëjtë midis të miturve, prindërve, mësuesve, rrethit shoqëror.
 - Tendenca për të gjetur “fajin”; shkakun, faktorin të të tjerët, dominon si të miturit, ashtu dhe të prindërit, mësuesit, etj.
 - Të pyetur për të përcaktuar rëndësinë e tre kategorive kryesore (familja, shoqëria, shkolla), prindërit listojnë shkollën dhe shoqërinë si kontributorë të situatave konfliktuale, kurse të miturit listojnë familjen dhe shkollën (*prindërit tentojnë ta mbajnë diskrete situatën familjare, kurse të miturit tentojnë të mbrojnë rrethin shoqëror*)
 - Vihet re numër i konsiderueshëm i përfshirjes së vajzave në situata konfliktuale, shoqërore dhe familjare, në kontakt dhe konflikt me ligjin.
 - Rastet e të miturve në projekt kanë treguar se të gjithë anëtarët e familjeve përkatëse janë të ndikuar negativisht, pavarësisht nivelit të ndryshëm të ndikimit.
- personality of the child.
- Children, parents, teachers and the social circles have a different understanding of how and why a situation of contact/conflict with the law occurs.
 - The tendency to blame others or to perceive that push causes/factors come from elsewhere, is quite prevalent among children, parents and teachers alike.
 - Parents rate the school and the society as the main contributors to conflictual situations, whereas children list the family and the school (*parents try to be discreet about their family circumstances, while children try to protect their friends*).
 - There is a considerable number of girls involved in social and family conflict situations, whether in contact or in conflict with the law.
 - Cases of children involved in the project demonstrate that all members of the respective family are adversely impacted by the criminal offence, irrespective of the level of impact.



Rezultatet Results

Rezultatet

Rezultatet e sesioneve të trajnimeve

- Njohja dhe informimi mbi kuadrin ligjor u mirëprit nga të gjithë, si prindër, ashtu edhe të mitur. Të gjithë treguan një motivim dhe interesim të lartë për të marrë pjesë në këto tema, si dhe një frymë graduale gjatë programit për qëndrim konform ligjit.
- Të pyetur përpara dhe pas sesioneve të njohjes me kuadrin ligjor si dhe pas sesioneve praktike të gjetjes së zgjidhjeve të tilla të konflikteve që nuk linin asnjë të humbur, niveli i pohimit të qëndrimeve konform ligjit, ka ndryshuar në mënyrë pozitive.
- Angazhimi i institucioneve edukuese, ligjzbatuese dhe atyre të sistemit të drejtësisë ishte i plotë. U arrit të vendoset njohje dhe komunikim mes gjithë palëve të përfshira (prindër, të mitur, institucione edukuese, ligjzbatuese dhe të drejtësisë).
- Nga programi i prindërimit dhe trajtimi i dhunës në familje, rezulton se njohja me çështjet gjinore dhe edukimi me barazinë gjinore brenda në familje, kontribuon në uljen e dhunës në familje, si nga ana e prindërve dhunues ashtu dhe të të miturve dhunues.
- Njohja dhe aplikimi i barazisë gjinore ndihmon prindërit në rritjen e fëmijëve sidomos gjatë adoleshencës, si dhe të miturit në formëzimin e sjelljeve sociale sipas normave në shoqëri.

Gjatë zbatimit të programit, të miturit reflektuan një nivel më të lartë ndërgjegjësimi mbi barazinë gjinore dhe rolet gjinore se sa prindërit, dhe janë më të prirur të

Results

Results of training sessions

- Legal information and awareness was very much welcomed by all participants in the programme, whether parents or children. All of them agreed to become part of the programme wholeheartedly and there was even a general desire noticed gradually through the programme, to behave in full conformity with the laws.
- Interviewed at the beginning and at the end of the first phase of the training and conflict resolution workshops, participants displayed a positive change in their statements and attitudes towards law-abiding behaviours. This was due to the legal awareness, on the one hand, and their engagement in seeking win-win solutions through the programme, on the other.
- The education, law-enforcement and justice institutions were also fully engaged and embraced the programme. As a result, a triangular dialogue, mutual awareness and communication was established between children, parents and institutions.
- The establishment and implementation of the parenting programme demonstrated that gender equality awareness and education, particularly within the family, contributes to the reduction of violence between parents and children, regardless of who is the abuser, whether the child/adolescent or the parent.
- Gender equality awareness and application of its principles helps parenting, particularly through the

ndryshojnë pozitivisht qëndrim ndaj dhunës në familje (53% kundrejt 49% të rasteve të trajtuara) si dhe të shfaqin qëndrueshmëri më të lartë në sjelljen e re (17% kundrejt 12%).

adolescence years; it also helps children/adolescents to shape law-abiding social behaviours.

During the programme implementation, children / adolescents reflected a higher level of awareness on gender equality and gender roles than their parents, and demonstrated a higher inclination to positively change their attitudes with regard to domestic violence (53% against 49% of the participants, respectively). In addition, participant children/adolescents demonstrated a stronger sustainability of the new behaviour (17% against 12%).





Disa reflektime
Some reflections

Disa reflektive

Pavarësisht se mund të arrihet pohimi pozitiv i qëndrimit konform me ligjin, ndryshimi i sjelljes është një proces i gjatë, i vështirë dhe përfshin shumë faktorë dhe aktorë, sidomos brenda familjes (*ku dispozicioni për ta ekspozuar është më i ulët*).

Në varësi të shkallës së sjelljes deviante të të miturit dhe faktorëve influencues, përveç trajtimit në grup, ka nevojë dhe për trajtim individual shtesë me bazë familjen.

Shpeshherë, pavarësisht dëshirës për të ndryshuar pozitivisht, ndikimi i faktorëve të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm (si ushtrimi i dhunës psikologjike, fizike, verbale, ekonomike, neglizhenca, etj.), pengon procesin e ndryshimit pozitiv të sjelljes dhe madje rrezikon të rikthejë agresivitetin, apo të rrisë nivelin e kontaktit dhe konfliktit me ligjin të të miturit.

Në këtë kuadër, fokusi i një ndërhyrjeje më të thelle me bazë familjen u shtua gradualisht në program. Gjatë fazës së dytë, metodologjia përfshiu më gjerë:

- Aspektin e ndërtimit të marrëdhënieve në familje, si faktorë të mjedisit të brendshëm të të miturit;
- Aspektin e ndërtimit të marrëdhënies prind - të mitur, si faktor mbështetës dhe kontributor në qëndrueshmërinë e qëndrimit të ri konform ligjit;
- Aspektin e krijimit të efektit amplifikues në mjedisin e jashtëm të të miturit, nëpërmjet angazhimit dypalësh prind-të mitur në aktivitete sociale/komunitare/ndërgjegjësuese (veçanërisht gjatë 16 ditëve të

Some reflections

Notwithstanding this positive change in the statements and attitudes towards law-abiding behaviours, in fact, behavioural change is a long and difficult process that involves many factors and stakeholders, particularly within the family (*which tends to keep things as unexposed as possible*).

Depending on the seriousness of the anti-social behaviour of the child / adolescent and the push factors, an individual, family-based treatment is necessary, in addition to group sessions.

Oftentimes, despite a genuine desire to change for the better, remaining factors, such as domestic violence, child neglect, pervasive gender stereotypes, discrimination, social exclusion, etc., may interrupt, challenge or slow down the process of positive behavioural change and in some cases risks to revert some children into an aggressive behaviour or in conflict with the law, while also increasing the risk to become a victim of crimes, for some others.

In this light, an added focus of deeper engagement at the family level was gradually brought into the programme. During the second phase, the methodology was expanded to involve:

- Working on the relationships within the individual family as important factors of the internal environment of the child;
- Building the child-parent relationship, as a support factor and contributor to the sustainability of the newly acquired law-abiding behaviour;

aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave).

Avantazhet e vëzhguar nga aplikimi i elementit shtesë në metodologji:

- Rastet e trajtuara shfaqen qëndrime të reja, në të mirën e tyre dhe konform me normat shoqërore dhe ligjin.
- Qëndrimet e reja janë konstante. Nuk janë vënë re luhatje të sjelljes së ndryshuar, që ul riskun e përsëritjes së konfliktit me ligjin.
- Qëndrimet e reja paraqesin nivel qëndrueshmërie më të lartë në rastin e të miturve të trajtuar me prindërit, sipas metodologjisë shtesë. Ata janë të përfshirë në modele pozitiviteti dhe në angazhim për të avancuar në jetë, jo thjesht për të qenë konform ligjit.
- Prirja e mbështetjes së të miturit nga anëtarët në familje është më e lartë.
- Prirja që i mituri me qëndrimin e ri dhe me ndihmën e prindit të transmetojë një model pozitiv brenda familjes është më e lartë, si dhe ka shanse që të jetë këshillues dhe parandalues për konfliktet e anëtarëve të tjerë brenda dhe jashtë familjes, sidomos për motrat dhe vellezërit më të vegjël.
- Modelet tradicionale të perceptimit të roleve gjinore dhe asociimit të disiplinës me dënimin janë zbehur në rastet e trajtimit shtesë.

- Creating an amplifying effect into the external environment of the child, through the engagement of the parent-child pair in community work, in social and community awareness activities (particularly during the 16 days of activism against violence against women and girls)

The advantages observed upon application of the added element in the methodology:

- The cases displayed new attitudes, beneficial to them, as well as in conformity with the law and positive social norms.
- The new attitudes seem to become more sustainable, with less fluctuation, which speak of reduced risk of recidivism.
- The participants of the additional parent-child treatment display a higher engagement in positive models as well as a more ambitious view towards life and own advancement, gradually replacing the mere desire to behave in conformity with the law.
- The tendency of the family members to play a supportive role to the child and their behavioural change is higher.
- With the new attitudes embraced, and with the better support of the parent, the child is more prone to display a model behaviour at home, to even push younger siblings into law-abiding lifestyles and to play a preventive role for conflicts, whether within or outside of the family.
- The traditional stereotypes or perceptions regarding gender roles, or the association of discipline with punishment have relatively lightened during the additional treatment.



**Mesazhe nga të miturit
në konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre**

**Messages from children in conflict with the
law and their parents**

Mesazhe nga të miturit në risk / konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre

A.C 14 vjeçe jeton me mamanë, motrën dhe vëllain. I ati është konsumues i alkoolit, gjë që përbën edhe një ndër shkaqet kryesore të dhunës në familje. Gjithashtu familja ndodhet në kushte shumë të vështira ekonomike (prindërit e papunë, shtëpi me qera). Babai nuk është i pranishëm në kujdesin ndaj shtëpisë dhe familjes. A.C me të ëmën i janë drejtuar disa herë komisariateve të policisë për të kërkuar ndihmë, por asnjëherë urdhër mbrojtjeje.

"Babi im nuk duket fare në shtëpi, ai edhe kur vjen ndonjëherë, rref mamin e ikën prapë. Problemi im tani është me mamin, e cila është bërë tamam si ai. Më gjuan, më shkul flokët, më bërtet, më kontrollon për çdo gjë, as në shkollë nuk më le të iki. Për gjënë më të vogël më gërthet dhe më gjuan. Jam gjithë nerva dhe e mërzitur. Mamit tani as i them asnjë gjë se s'ja vlen. Vetëm me motrën flas,me thënë të drejtën, shajmë mamin se na e ka sjellë majë hundës." - AC

"Po çfarë të bëj? E rrah ndonjëherë gocën, se s'merr vesh ndryshe. Edhe ajo ka filluar të më kthejë fjalë. Ku marrin vesh këta fëmijët e sotëm! Kot s'ka thënë populli "Druri ka dalë nga xheneri". "Burri? Ca të them e zeza për të! Na shkatërroi. Mua më ka fut në dhe nga turpi. Kam ngel gru pa burrë për komshinjtë. Le që na turpëroi duke pi e ardh vërdallë, pa punë, pa asnjë gjë, po duket njëherë në hënëz dhe më bën për spital. Më vjen turp nga ato që më njoftin, por të paktën mundohem që drurin ta mbaj vetë, që të shkarkohet te unë e mos gjuaj kalamajtë. Cuni ka filluar të bëjë si komandant shtëpie, por më hall kam këtë gocë. Shpirti ma di që kaq e vogël dhe filloi dyerve të policisë. S'dua të më turpërojë, as të ngatërrohet me ndonjë djalë të keq, as të thonë komshinjtë "goca e filanit." - Nëna e A.C

Messages from the children in conflict / contact with the law, and their parents

A.C A.C is 14 years old and lives with her mother, her sister and her brother. Her father is an alcoholic and domestic abuser. The family is very poor; parents are unemployed, they live in a rented house. The father is not present to take care of the family. A.C and her mother have oftentimes sought police assistance but have never requested a protection order.

"My father doesn't even come home; even when he comes over, he beats my mother up and then goes away. I have a problem with my mother, who has now turned to be just like him. She hits me, she pulls my hair, is super-controlling and doesn't let me go to school. For the slightest thing, she yells and hits me. I am so upset and sad. I don't tell my mother anything anymore, because it's not worth it. I just talk to my sister ...in fact we get together and badmouth our mother because we've had enough." - A.C

"But what can I do? Yes, I hit my daughter sometimes, because she doesn't understand otherwise. She has even begun to contradict me. Today's children don't know any better. The proverb is right: "The stick [battery] derives from paradise." My husband? What can I say about, poor me? He destroyed us. I feel buried under a mountain of shame because of him. Our neighbours see me as a single mother. Not only does he bring shame to us all with his drinking, unemployment and lack of engagement, but even in those rare cases that he comes home, he makes me seek hospitalisation. I am so ashamed from people that know me, but at least, I try to serve as a target for his battery, so that he discharges all his stress on me, rather than hitting my kids. My son has begun to behave like the king of the castle, but my biggest problem is my daughter. It hurts me that she started to visit the doors of the police at such a young age. I don't want her to bring shame on me, I don't want her to hook up with some

Si pjesë e programit, trajtimi i sesioneve prind-fëmijë u përqendrua në rregullimin e marrëdhënieve të tyre, në ndryshimin e perceptimit që ato kanë ndaj njëra-tjetrës, nga skemat sulm-mbrojtje në skemat mbështetese, për të përballuar situatat, si dhe për të qënë pozitive dhe ndaj dy pjesëtarëve të tjerë të familjes. Më poshtë janë mendimet e tyre pas ndjekjes së programit:

"S'kam patur ndonjë sherr. Mami është bërë mirë, si bosa i them, se vjen e hyn në muhabetë me mua dhe motrën, e bëhemi të treja si grup. E ka liru pak kontrollin, vazhdon thotë kujdes këtu, kujdes me filanin etj., po i thotë tani si më qetë. Në shkollë shkoj. Do kisha qejf të bëja ndonjë gjë gjatë verës, që mos të rrija në shtëpi." A.C

*"Qyqa, me këto që mësova, për Zotin, paskam qenë më keq se burri. Më raftë pika që e kam rraf gocën, kot më si kot! Tashi dhe ajo duhet me ul içik nervat e të sillet më mirë, po për Zotin tani vetëm i kam gërthit ndonjëherë, por për ta rraf, jo. Ajo që na thatë me bo një gjë bashkë se na bën mirë? Morëm qëndisëm bashkë kryq një rrugicë thesi. Unë nga njëra anë, goca nga ana tjetër. Të betohem, qëndisnim dhe tregonim qyfyre. Për marshalah, thashë me vete. Rrofshit ju!
Për burrin, ja le të vijë e ta shofi kufirin, se e di shumë mirë ca të kërktoj nga policia. Urdhër mbrojtje!" - Nëna e A.C*

bad guy, I don't want the neighbours to point at her and say "She is Doe's daughter". - The mother of A.C.

As part of the UNICEF programme, the parent-child sessions worked to rebuild the relationship between mother and daughter, to change the perceptions they have of one-another, to transition from the attack-defence relationship style to a more supporting scheme, with a view to face difficulties together and to play a more positive role towards the other two members of the family. The following are their comments after participation at the programme.

I haven't picked up any fighting. Mom is cool now, she talks to me and to my sister; we are friendly again, the three of us. She is not as controlling as she used to be, although she advises me to be careful here, with that person there, and so on, but she keeps her calm when she does. I now go to school. I wish I could do something during the summer so that not to stay at home." - A.C

"Oh my God! With what I learned today, I realise that I have acted worse than my husband towards my children. I should be dammed for beating my daughter in vain. She needs to readjust her tone and behave better, though, but from our sessions to date, I never laid my hand on her, although I still raise my voice sometimes. The advice that you gave us to do something together, was great! We picked up a runner and cross-stitched it together. I was embroidering from one side, my daughter from the other. I swear, we sat together, we had some work done and we talked and laughed again. I was so happy. Many thanks to you.

As for my husband... let him show his face and I will set my boundary. I know now what to request from the police: a Protection Order! - The mother of A.C.



A.F 17 vjeç vjen nga një famije e komunitetit rom, me dënim alternativ për vjedhje. Ai jeton së bashku me prindërit dhe vëllezërit e martuar me fëmijët e tyre, në të njëjtën banesë. A.F nuk e ka përfunduar arsimin nëntëvjeçar, kurse i ati, punon duke mbledhur kanaçe dhe hekurishte .

“Ishte e rond kur m’ka kap policia e m’futën n’burg. Me thën t’drejtën kisha içik frik. T’gjith çunat e kan provu ka iher burgun. Hera e par që m’kapën se unë kam pi dhe hashash, por kam shpëtu.” - A.F

“M’ka ardh shumë keq kur e arrestun çunin, se nuk dija ku të përplasja kokën dhe nuk kisha as lek. E di që im bir ka bo gabim dhe un s’e kam kontrollu ...por s’kam ca t’boj. Gjith ditën rri duke mbledh kanaçe mes diellit e mes ftohtit. Vij në shpi e jam l lodh Di unë ç’bën ky rrugve. Edhe shkollën e la.” - Babai i A.F

Trajtimi i dyshes prind – fëmijë në rastin e tyre u fokusua në ndërtimin e marrëdhënies baba-bir për gjetjen e mënyrave në zgjidhjen e konflikteve, duke qënë se jetojnë dhe me shumë pjestarë në familje.

Si i mitur në konflikt me ligjin dhe në vuajtje të dënimit alternativ për vjedhje, trajtimi i A.F është fokusuar më tej, në gjetjen e mënyrave për t’u riintegruar, specifikisht duke e nxitur të punojë dhe duke i listuar të mirat, jo vetëm ekonomike por dhe në shoqëri.

“Jam sjell mirë, i rri larg ngatarrësave. Me thon t’drejtën, shoh nonji gjo që s’m’pëlqen, largohem se s’du t’ngatarrohem kot. Po punoj me plakun me kanocet. Ishalla filloj nonji pun si mekanik makinash se i kom qef shumë e ju do m’nimoni se per shkoll s’ja them.” – A.F

A.F A.F is a 17 years old boy from a Roma family. He was given an alternative sentence for stealing. He lives with his parents, as well as his married brothers and their children, in the same house. A.F did not complete the compulsory education. His father makes a living out of tins and other metallic objects he collects in the garbage bins for recycling.

“When the police caught me and put me in jail, it was very hard on me. To be honest I was a bit scared. All the boys have had a little flavour of the prison. This was the first time they captured me; I used to smoke hash, but managed to get away with it.” - A.F

“I felt so bad when they captured my boy; I didn’t know where to go, who to turn to. I didn’t have any money. I know he has done something wrong, and I have not checked up on him... but what can I do? I spend my entire day going around the bins, collecting tin containers, come rain or come shine. When I come home I’m exhausted. I have no idea what has he been up to, out in the streets. He also dropped out of school.” – The father of A.F

The treatment of this parent-child pair focused on building the relationship between the two, with a view to engage them in finding ways to resolve conflicts, given that they live in an extended family.

Given that A.F was in conflict with the law, and serving his alternative sentence for theft, his treatment included efforts to find ways and support his reintegration and to encourage him to work. The overall approach reinforced the positive aspects of work, not only in economic but also in sociability terms.

“I’ve been behaving and staying out of trouble. When I spot something happening that I don’t like, I get out of sight, because I don’t wish to get involved. I am working with my old man collecting tins. I hope to find employment as a mechanic ‘cause I’m fond of cars. School ain’t my thing.” – A.F

Xh.H 15 vjeç është në klasën e nëntë dhe ka rezultate shumë të ulëta në mësim. Ai ka pasur probleme të herëpashershme me policinë. Herën e parë është konfliktuar verbalisht dhe fizikisht me një shokun e tij dhe e ka kërcënuar me armë. Më pas, sërish është kapur nga policia për shpërndarje dhe përdorim të lëndëve narkotike dhe është mbajtur disa ditë në paraburgim.

Familja e tij përbëhet nga gjashtë anëtarë. Të ardhurat e familjes janë tepër të ulëta, sepse babai punon (sezonalisht) në ndërtim. Vajzat e familjes nuk e kanë vazhduar dot ciklin e mesëm të shkollës, për shkak të vështirësive ekonomike.

“Kam qenë shumë herë në rajon policie dhe më pas kam dalë. S’dua të sillem keq, por ja që detyrohem ndonjëherë. Më vjen keq që i mërzis prindërit, sidomos babin” – Xh.H.

“Më vjen shumë keq për vajzat që i lashë pa shkollë, por nuk kisha mundësi. Këtij të voglit, që ia kam plotësuar të gjitha, ky po më mundon më shumë. Më nxjerr nga bina-rët.” Babai i XH.H

“Ky djalë nuk bëhet... do mbesi burgjeve” – të tjerë

U konstatua që i mituri vuante nga përjashtimi social dhe dhuna verbale dhe psikologjike. Sidomos i ati që e konsideronte si dështim personal, mirëpo i mituri, në vetvete, e kërkonte vlerësimin e të atit. Trajtimi i dyshes prind – fëmijë në rastin e tyre u fokusua në gjetjen e një linje të përbashkët komunikimi, në vetëvlerësimin si dhe në rrethin e njohjes.

Sot, Xh.H dhe babai janë pjesë e dysheve prindër-të mitur që punojnë për të bindur të tjerë të mitur në kontakt

Xh.H 15 years old is in ninth grade but not doing well at school. He has had frequent episodes with the police. The first time he got into a fight with a friend of his, there was verbal and physical abuse involved, and he threatened his friend with a weapon. He has also been captured by the police while using and selling narcotics and has spent several days in pre-trial detention.

He lives in a family of six. The family struggles with their finances, because the father only gets seasonal jobs in construction. The daughters of the family could not continue with their secondary education due to economic reasons.

“I have been apprehended by the police several times, and then they let me go. I do not want to misbehave, but sometimes I have to. I am sorry I upset my parents, in particular my dad.” – Xh.H.

“I am very sorry about my girls whom I could not give the opportunity to advance with their schooling, but I could not afford it. This one, is the youngest. I have tried to give him everything he asks for, but he is the one who is giving me the worst headache. He drives me insane.” -The father of Xh.H.

“There is no hope for him... he will likely pass his life in and out of jail” – others

The programme team realised that this child suffered social exclusion, and was also subjected to verbal and psychological abuse. His father viewed him as a personal failure and felt very hurt, whereas inside, Xh.H longed for his father’s acceptance. Therefore the programme team focused their efforts in building the parent-child relationship in that direction, in identifying common grounds for communication,

apo në konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre, për të pranuar ndihmën nga projekti. XH.H është tashmë dhe vullnetar pranë "Sot për të Ardhmen", për të ndihmuar fëmijët gjatë kampit veror.

"Vërtet mendoni se unë mund të ndihmoj dhe prindër të tjerë? Po jam gati!" – Babai i XH.H

through the process of building self-esteem and the recognition circle.

Today, Xh.H and his father are part of the engaged parent-child pairs who work to raise awareness and to help other children in contact/conflict with the law and their parents, to learn about the programme and join it. Xh.H has become part of the volunteers of the Community Development Centre and helps other children participating in the Centre's programmes.

"Do you really think I can help other parents? Why... most certainly! I am ready!" - The father of Xh.H



A.B 17 vjeçe, është në shkollë të mesme profesionale. I ati punon me kohë të pjeshme në ndërtim dhe familja ndodhet në kushte të vështira ekonomike. A.B shfaq sjellje rebeluese dhe konfliktuale me shoqërinë e saj dhe në shkollë. Ajo ka marrë disa herë masa paralajmëruese për përjashtim nga shkolla, për shkak të frekuentimit jo të rregullt dhe sjelljeve të dhunshme në mjediset e shkollës ndaj bashkëmoshatarëve dhe mësuesve. Në këtë rast policia është mjafuar me vërejtje dhe është lënë në gjendje të lirë.

"Unë kam shkuar disa herë në polici, por nuk është faji im. Mua më ngacmojnë shoqet dhe unë i toleroj derisa nuk mban më durimi im. Nuk jam krenare për këtë gjë, por të tjerët e dinë çfarë tipi jam dhe më ngacmojnë kastile..." - A.B

"Të ëmën nuk e llogarit fare. Mua më dëgjon disa më shumë. E kemi si çun." - babai i A.B.

"Po erdhi plaku në takim, unë do iki. Po të jemi vetëm çuna, goca flas. Përndryshe e qep gojën" - A.B

"S'ka problem. Po qe se nuk do që të jem, më mirë veç" - babai i A.B

Duke vëzhguar sjelljen të mitur dhe prind, trajtimi i marrëdhënies së tyre prind-fëmijë u vendos në një etapë të dytë, u konstatua se prindi në këtë rast ishte "pasues," ndaj fillimisht u punua me të miturën në kanalizimin e energjive të saj. A.B e projektonte potencialin e saj për të "drejtuar" në trajtën e konfliktit pasi në ambientin shoqëror ndihej inferiore për shkak të varfërisë. Trajtimi u fokusua që vetë-vlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët mund të realizohen duke vënë në zbatim aftësitë dhe inteligjencën konform ligjit. Pas trajtimit individual mbi perceptimin dhe kuptimin e dashurisë dhe cilësive prindërore, pavarësisht mundësive ekonomike, A.B pranoi të ndiqte trajtimin prind – fëmijë. Nuk ka patur më raportim nga shkolla për përfshirje të të miturës në sjellje të dhunshme apo armiqësore ndaj të tjerëve.

"E kam rob të mirë, plakun. I kam rënë ca në qafë. Është pak më i urtë seç duhet, po nuk më fëlliq." - A.B

"Po sikur është urtësuar goxha!" - babai i A.B .

A.B A.B. is a 17 years old girl who goes to a vocational education training school. Her father does part time construction work, and her family's financial situation is difficult. A.B displays rebellious and conflictual behaviour at school, and with her peers. She has received many warnings at school and risks expulsion for irregular attendance and violent behaviour, directed towards school mates and teachers. The police also gave A.B a warning, although they let her go free.

"I have ended up at the police station several times, but it is not my fault. My friends pick on me and I can only tolerate them so much. I'm not proud of it, but they know how I'm like, and they do it on purpose to get on my nerves..." - A.B

"She pays no attention at all to her mother. She gets better on with me. She is like a tomboy." - The father of A.B.

"If my old man comes here, I'm out! If it is just us, boys and girls, yes, I can talk. Otherwise, I'll keep to myself and zip it." - A.B

"No problem. If she does not want me around, let's stay in separate groups." - The father of A.B

The observations of the parent and child convinced the programme team to postpone the parent-child treatment at a second stage, given that the parent was more of a "follower." Therefore, at first, the focus of the intervention was on A.B, in helping her redirect her energies. A.B projected her desire to "lead" in a social environment where she felt economically inferior, in the form of a conflict. The treatment focused in making her see that gaining the respect of others and building her self-esteem could be possible, if using one's intelligence and skills, without breaking the law. Then the programme team further worked with A.B to help her better see her parents love for her, to help her understand her parents' qualities, despite their economic limitations. It was only then that A.B agreed to attend parent-child sessions with her father. There have been no more reports of A.B's involvement in violent or hostile behaviours against others at school.

"My old man is cool, I have given him a hard time. He is softer than he should be, but he does not embarrass me." - A.B

"She seems to have calmed down quite a bit!" - The father of A.B

K.A dhe K.M janë kapur teksa shpërndanin lëndë narkotike dhe janë dënuar nga gjykata e shkallës së parë me 40 ditë heqje lirie, dëmin të cilin e kanë kryer me burgim dhe janë me detyrim paraqitje pranë institucionit të Shërbimit të Provës. K.A është është fëmijë konfliktual në familje dhe në shoqëri, kurse K.M është konfliktual, përdorues i rregullt i lëndëve narkotike si dhe shpërndarës. Marrëdhëniet e tyre janë K.M lider dhe K.A pasues. Nëna e K.M shfaq distancim nga i biri për shkak të turpit shoqëror, kurse K.A përbuz të atin për shkak të varfërisë.

"Nuk kam ca them." - K.A.

"Ca të them. Iku, u bë." K.M

"Aman, ndihmojeni të bëhet njeri! Vëreni në punë, këtu në qendër, të edukohet, të rrijë me njerëz të mirë, t'i kthehet shkollës. Unë jam në pension, nuk e ndihmoj dot." – babai i K.A

"Ju lutem, mund të mos vi unë në takim? Më vjen shumë zor..." – nëna e K.M

Në programin e UNICEF, të dy rastet dhe me udhëzim nga Shërbimi i Provës u trajtuan me skemën: prind-fëmijë (veçmas), si dhe marrëdhënia mes dy shokëve. Pas pjesëmarrjes në program, K.A ka vendosur të përsëritë vitin e tretë të shkollës së mesme dhe synon të diplomohet. K.M është regjistruar si vullnetar pranë Qendrës Komunitare. Ai ndihmon në aktivitetet me të moshuarit. Ai po zhvillon talentin e tij në ideimin e një faqeje interneti për turizmin dhe po punon me "Sot për të Ardhmen" për të nisur kursin e guidave malore. Shërbimi i provës ka konstatuar që të dy janë më socialë me njerëzit.

"Janë mburrur shokët kur kanë qenë shoqëruar në komisariat, por burgu ishte ndryshe. Do bëja çdo gjë për mos u kthyer atje. Shkollë, punë...çdo gjë." – K.A

"Më pëlqen më shumë puna që bën qendra me të moshuarit dhe interneti." – K.M

K.A and K.M K.A and K.M were caught distributing drugs, and have been sentenced by the first instance court with 40 days of prison. After release from the penitentiary, they are required to appear periodically at the Probation Service of Puka. K.A is a conflictual child at home and with his peers, while K.M is conflictual, a regular drug user, and distributor as well. K.M is the "leader" and K.A is his "follower". The mother of K.M feels social shame on account of her son, while K.A is disgusted by his father because he is poor.

"I do not know what to say." - K.A.

"What can I say? Let bygones, by bygones." K.M

"Please, try to help him become a human being! Make him work, train him to stay with good people, and make him go back to school. I am retired and I cannot help him" –The father of K.A

"Please, I do not want to be in the meeting. I am too embarrassed" –The mother of K.M

In the UNICEF program, both cases, with the instruction of the Probation Service, as well, were addressed through the following schemes: parents-children (separately), and the relations among the two friends. After the participation in the programme, K.A decided to repeat his third year of secondary education, and aims to get a diploma. K.M is now registered as a volunteer at the Community Centre. He helps out with the activities for the elderly. He has been able to develop his talent and built a website to promote tourism in his home town. He is working with the Centre, with a view to join the course for mountain touristic guides. The Probation Service has noticed that both are now more sociable.

"My friends were boasting about being taken to the police station, but to actually go to jail is different. I would do anything it takes not to go back. School, a job...anything." – K.A

"I love the work with the elderly and the internet." – K.M

Rrjeti “Sot për të Ardhmen”

“Sot për të Ardhmen” është rrjet lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë. Udhëhequr nga vizioni dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, “Sot për të Ardhmen” ka krijuar përqasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve, përfshirjes dhe mobilizimit komunitar, ushtrimit të së drejtës qytetare, respektimit të ligjit, në mirëqeverisje dhe bashkëpunim institucional.



Zyra Koordinuese Tiranë:

Adresa: Rr. Elbasanit, P. Abau, H2,K6, AP 13, Tiranë
Tel & Fax: +355 4 230 24 10

Qendra Komunitare Durrës:

Adresa: Rr. Leon Tolstoi, Lagja 17, skolina 5, Ish-Kenete, Durres
Tel: +355 5 290 10 70

Qendra Komunitare Pukë:

Adresa: Sheshi Tërbuni, Sh5, pranë Bashkisë Pukë, Pukë
Tel: +355 2 122 29 19



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të ardhmen”
Integrimi dhe ri-integrimi i të miturve në shoqëri / Qendra
për zhvillim komunitar “Sot për të ardhmen” ; përkth.
Evis Cerga. – Tiranë : Sot për të ardhmen, 2016
36 f. : me foto ; 24 x 19 cm.
ISBN 978-9928-4302-2-9

1. Të rinj 2. Puna me individë dhe familje me probleme sociale
3. Projekte të zhvillimit 4. Shqipëri

364.4 -053.6(496.5) (083.94)

“Today for the Future” Network

“Today for the Future” is a leading network in Albania for mobilization and empowerment of communities in need. Driven by the vision as well as using innovative methods, “Today for the Future” has scored successful approaches of gender empowerment, volunteering, activism, environment protection, employment mediation, services, community participation and inclusion, exercise of civic rights, rule of law, good governance and institutional cooperation.



Tirana Coordination Office:

Address: Rr. Elbasanit, P. Abau, H2,K6, AP 13, Tirana
Tel & Fax: +355 4 230 24 10

Durres Community Center:

Address: Rr. Leon Tolstoi, Lagja 17, skolina 5, Ish-Kenete, Durres
Tel: +355 5 290 10 70

Puka Community Center:

Address: Sheshi Tërbuni, Sh5, pranë Bashkisë Pukë, Puka
Tel: +355 2 122 29 197



Tirana National Library Cataloging-In-Data

Community Development Center “Today for the Future”
Integration and re-integration of minors in society / Community
Development Center “Today for the Future” ; transl.
Evis Cerga. – Tirana : Today for the Future, 2016
36 p. : with photos ; 24 x 19 cm.
ISBN 978-9928-4302-2-9

1. Youth 2. Work with individuals and families with social problems
3. Development projects 4. Albania

364.4 -053.6(496.5) (083.94)



Rrjeti për Zhvillim Komunitar
"Sot për të Ardhmen"
"Today for the Future"
Community Development Network

-  info@cdc-tff.org
-  www.facebook.com/AlbanianCommunityCentre
-  www.youtube.com/SotPerTeArdhmen
-  www.twitter.com/SotPerTeArdhmen
-  www.cdc-tff.org

ISBN: 978-9928-4302-2-9



9 789928 430229

**Programi për integrimin dhe ri - integrimin
në shoqëri të të miturve në konflikt ose në
kontakt me ligjin përmes normave dhe
vlerave shoqërore në respektim të ligjit**

.....

**Social Integration and Re-integration
Programme of children in contact or
conflict with the law through norms,
values and a law - abiding lifestyle**



Përmbledhje Ekzekutive

- PROFIL -

Kjo broshurë ka për qëllim të paraqesë rezultate dhe rekomandime të dala gjatë zbatimit të programit "**Integrimi dhe Ri-integrimi i të miturve në shoqëri nëpërmjet normave, vlerave dhe të jetuarit sipas ligjit**", realizuar nga Rrjeti "Sot për të Ardhmen", në partneritet me **UNICEF Shqipëri dhe me mbështetjen e Qeverisë Suedeze**.

Qëllimi i programit është të kontribuojë në edukimin e fëmijëve dhe sidomos të atyre në konflikt me ligjin, për të vepruar dhe jetuar në përputhje me vlerat, normat dhe ligjet në fuqi.

Programi kishte për qëllim që nëpërmjet sesioneve të trajnimeve, sesioneve të mbështetjes dhe trajtimit të rasteve, programit të prindërimit, këshillimit individual dhe në dyshe prind-fëmijë, si dhe përfshirjes në grupe komunitare të arrihej: • njohja e fëmijëve dhe prindërve me **kuadrin ligjor** dhe edukimi me vlerat dhe normat shoqërore; • përfshirja e tyre në situata **zgjidhjeje konflikti**; • nxitja për të **ushtruar dijen e marrë** dhe për të ndarë përvojat me grupin; • **prindërim** më cilësor dhe aktiv; • **komunikim** më pozitiv prindër – fëmijë; • njohja e koncepteve të **barazisë gjinore** dhe praktikimi i tyre.

Në ndërveprim të përbashkët me specialistët e sistemit të drejtësisë, rezultoi se **të miturit në konflikt me ligjin të cilët merrnin mbështetjen e prindërve, kishin më tepër gjasa të largoheshin nga sjelljet destruktive dhe anti-sociale**.

Në përfundim të programit:

- 53% e fëmijëve me sjellje problematike shfaqën sjellje të përmirësuar;
- 49% e prindërve shfaqën qëndrim të përmirësuar ndaj fëmijëve të tyre;

Në program u përfshinë rreth:

- 190 fëmijë dhe të rinj në konflikt/kontakt me ligjin (56% djem dhe 44% vajza);
- 150 prindër; si dhe
- institucionet publike: Gjykatat, Zyrat e Shërbimit të Provës, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, Policia, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Shkollat 9-vjeçare, të mesme të përgjithshme e profesionale.

Vendndodhja: Tiranë, Durrës dhe Pukë.

Kohëzgjatja: 13 muaj (2015-2016)

- 17% e të miturve dhe 12% e prindërve kanë përqafuar një sjellje tërësisht të re (qëndrueshmëria e sjelljes), jo vetëm duke mos patur asnjë rast të përsëritur të sjelljeve deviate për të cilat janë trajtuar, por edhe duke shpalosur një model të ri qëndrimesh dhe sjelljesh në familje, shkollë dhe komunitet¹ ;
- Njohja e koncepteve gjinore ka rezultuar në rritje në masën 52% për të miturit dhe 56% për të rriturit;
- Praktikimi i elementeve të ndryshme të barazisë gjinore brenda familjes dhe në shoqëri ka rezultuar në rritje në masën 40% për të miturit dhe 42% për të rriturit (bazuar në vlerësimet para dhe pas ndërhyrjes).

1 Praktika për matjen e ndryshimit në sjellje dhe qëndrueshmërisë së qëndrimit të ri është bazuar në vlerësimin psikologjik dhe vëzhgimin e fëmijëve dhe prindërve, në dhënien e perceptimit të tyre, në përshkrimin dhe zgjidhjen e situatave prej tyre në fillim, përgjatë dhe në fund të ndërhyrjes.



Rrjeti për Zhvillim Komunitar
"Sot për të Ardhmen"
"Today for the Future"
Community Development Network

Mbështetur nga:
Supported by:



United Nations
ALBANIA

unicef
for every child

Executive Summary - PROFILE -

This brochure presents the results and respective recommendations developed during the implementation of the **“Social integration and reintegration of children through norms, values and law-abiding lifestyle”** Programme, implemented by the Community Development Center “Today for the Future”, in partnership with UNICEF Albania, with the financial support of the Swedish Government.

This intervention aimed at contributing to the education of children, and in particular children in conflict with the law, to act and live, in compliance with the values, norms and the law.

The intervention, through training sessions, case assistance and treatment sessions, a parenting programme, individual and parent-child pair counselling, as well as their involvement in community groups, aimed at:

- familiarising children and their parents with the **legal framework** and their education with social values and norms;
- involving them in **conflict resolution** situations;
- encouraging them to **apply the knowledge** gained and to share their experience with the group;
- promoting quality and active **parenting**;
- fostering a more positive parent-child **communication**; and
- promoting **gender equality** awareness and its application in practice.

In close cooperation with the justice system professionals, the programme team was able to observe that **those juveniles who enjoyed the support of the parents were more likely to move away from destructive and anti-social behaviours.**

By the end of the programme:

- 53% of children who had previously engaged in problematic behaviour, displayed improved behaviours.

The programme involved approximately:

- 190 children and adolescents in conflict/contact with the law (56% boys and 44% girls);
- 150 parents; and
- authorities: courts, probation, prosecution, police, regional education departments, primary and secondary schools.

Location: *Tirana, Durrës, and Puka.*

Duration: *13 months (2015-2016).*

- 49% of parents displayed an improved attitude towards their children.
- 17% of children and 12% of parents have embraced a totally new behaviour (sustainability of behaviour), not only accompanied by absence of previous deviant behaviours that brought them to the programme, but also by displaying a new model of attitudes and behaviours in the family, school and community.
- Gender equality awareness increased up to 52% among children/adolescents and 56% among parents,
- Practical application of the newly acquired gender equality awareness increased in 40% of children and 42% of parents (based on the evaluations conducted pre- and post-intervention)¹¹.

¹¹ The change in behaviour and sustainability of the newly acquired attitudes is measured through the psychological assessment and observation of children and their parents, in stating their perceptions, in describing and experiencing conflict resolution situations in the beginning, during and at the end of the programme.



Rrijeti për Zhvillim Komunitar
“Sot për të Ardhmen”
“Today for the Future”
Community Development Network

Mbështetur nga:
Supported by:



United Nations
ALBANIA

unicef 
for every child